

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO



FLETUDHËZIM PËR PACIENTË

Vasilip® 10 mg film tableta të mbështjellura
Vasilip® 20 mg film tableta të mbështjellura
Vasilip® 40 mg film tableta të mbështjellura
 Simvastatin

Lexojeni gjithë fletudhëzimin me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'ua bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njejta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor i cili nuk është përfshirë në këtë fletudhëzim, ju lutemi informoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Përmbajtja e fletudhëzimit:

1. Çka është Vasilip dhe për çka përdoret
2. Çka duhet të dini para se të merrni Vasilip
3. Si ta merrni Vasilip
4. Efektet anësore të mundshme
5. Si ta ruani Vasilip
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË VASILIP DHE PËR ÇKA PËRDORET

Vasilip përmban substancë aktive simvastatin. Vasilip është një bar që përdoret për të ulur nivelet e kolesterolit total, kolesterolin "i keq" (kolesterolin LDL), dhe substancave yndyrore të quajtura trigliceride në gjak. Përveç kësaj, Vasilip rrit nivelin e kolesterolit "të mirë" (kolesterolin HDL). Vasilip i takon grupit të barnave të quajtura statina.

Kolesterolin është një nga materiet yndyrore që gjendet në qarkullimin e gjakut. Kolesterolin juaj i përgjithshëm përbëhet kryesisht nga kolesterolin LDL dhe HDL.

Kolesterolin LDL shpesh quhet kolesterol i "keq" ngase mund të akumulohet në muret e arterieve ku formohen pllakëza. Eventualisht, grumbullimi i këtyre pllakëzave mund të shkaktojë ngushtim të arterieve. Ky ngushtim mund t'ua ngadalsojë ose bllokojë furnizimin me gjak të organeve vitale siç janë zemra dhe truri. Ky bllokim i furnizimit me gjak mund të shkaktojë sulm në zemër ose goditje në tru.

Kolesterolin HDL shpesh quhet kolesterol i "mirë" sepse pengon kolesterolin e keq që të grumbullohet në arterie dhe mbron nga sëmundjet e zemrës.

Trigliceridet janë formë tjetër e yndyrës në gjak të cilat mund të rritin rrezikun nga sëmundjet e zemrës. Duhet të jeni në dietë për uljen e kolesterolit derisa jeni duke marrë këtë bar.

Vasilip përdoret si shtesë për dietën tuaj për zvogëlimin e kolesterolit nëse:

- një nivel të ngritur të kolesterolit në gjakun tuaj (hiperkolesterolemia primare) apo nivele të larta të yndyrës në gjakun tuaj (hiperlipidemia e përzier).

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

- një sëmundje trashëgimore (hiperkolesterolemia homozigos familjare) që rrit nivelin e kolesterolit në gjakun tuaj. Ju mund të merrni edhe trajtime të tjera.
- sëmundje koronare të zemrës (SKZ) ose në rrezik të lartë të SKZ (sepse ju keni diabet, histori të sulmit, apo të tjera sëmundje të enëve të gjakut). Vasilip mund të zgjasë jetën tuaj, duke ulur rrezikun e problemeve të sëmundjeve të zemrës, pa marrë parasysh sasinë e kolesterolit në gjakun tuaj.

Në shumicën e njerëzve, nuk ka simptoma të menjëhershme të kolesterolit të lartë. Mjeku juaj mund të kontrollojë kolesterolin tuaj me një test të thjeshtë gjaku. Vizitoni rregullisht mjekun tuaj kontrollojeni kolesterolin tuaj, dhe bisedoni me mjekun për qëlimet tuaja.

2. ÇKA DUHET TË DINI PARA SE TË MERRNI VASILIP

Mos e merrni Vasilip:

- nëse jeni alergjik ndaj simvastatinës ose çfarëdo përbërësi tjetër të këtij bari (të shënuar në seksionin 6),
- nëse keni probleme me mëlçinë,
- nëse jeni shtatzënë apo ushqeni fëmijun me gjë,
- nëse aplikoni një ose më shumë, nga këto barna në të njëjtën kohë:
 - itrakonazol, ketokonazol, posakonazol ose vorikonazol (barna për infeksionet fungale),
 - eritromicin, klaritromicin, ose telitromicin (antibiotikë për infeksionet),
 - frenuesit e proteazës HIV si indinavir, nelfinavir, ritonavir dhe saquinavir (frenuesit e proteazës HIV përdoren për infeksionet HIV)
 - boceprevir ose telaprevir (bar kundër infektionit me virus hepatitis C),
 - nefazodon (një bar për depresion),
 - cobicistat,
 - gemfibrozim (bar për uljen e kolesterolit),
 - ciklosporin (bar i cili shpesh përdoret tek pacientët me organe të transplantuara),
 - danazol (hormon artificial i cili përdoret për trajtimin e endometriozës).

Mos merrni më shumë se 40 mg Vasilip nëse merrni lomitapid (i cili përdoret tek gjendjet serioze dhe të rralla të kolesterolit gjenetik).

Pyetni mjekun tuaj nëse nuk jeni të sigurtë se bari juaj është përmendur më lartë.

Keni kujdes të veçantë me Vasilip

- Tregoni mjekut tuaj në lidhje me gjendjen tuaj mjekësore duke përfshirë edhe alergjinë.
- Tregoni mjekun tuaj nëse ju pini sasi të mëdha të alkoolit.
- Tregoni mjekut tuaj nëse ju keni pasur ndonjëherë sëmundje të mëlçisë. Vasilip mund të mos jetë për ju.
- Tregoni mjekut tuaj nëse keni për të ju nënshtruar një operacioni. Ju duhet të ndërpreni marrjen e tabletave Vasilip për një kohë të shkurtër.
- Tregoni mjekut tuaj nëse jeni me prejardhje Aziatike, sepse mund të aplikohet dozë tjetër tek ju.
- Tregoni mjekut tuaj nëse merrni ose në 7 ditët e fundit keni marrë barin i cili quhet acidi fusididik, (bar për infeksione bakteriale) në mënyrë orale ose përmes injeksionit. Kombinimi i acidit fusididik dhe Vasilipit mund të shkaktojë probleme me muskujt (rabdomioliza).

Mjeku juaj duhet të ju udhëzojë ta bëni testin e gjakut para se të filloni të merrni Vasilip dhe nëse keni simptomat e problemit me mëlçinë deri sa të merrni Vasilip. Kjo nevojitet të kontrollohet se sa mirë funksionon mëlçia juaj.

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Mjeku juaj gjithashtu dëshiron ti bëni testet e gjakut për ta monitoruar funksionin e mëlçisë pas aplikimit të barit Vasilip.

Derisa aplikoni këtë bar, mjeku me kujdes do të ju përcjellë nëse keni diabet ose jeni në rrezik nga shfaqja e diabetit. Sigurisht jeni në rrezik nga shfaqja e diabetit nëse keni nivel të lartë të sheqerit dhe yndyrës në gjak, keni peshë të lartë dhe presion të lartë të gjakut.

Tregoni mjekut tuaj nëse keni sëmundje të rëndë të mushkërive.

Kontaktoni menjëherë mjekun tuaj nëse përjetoni dhimbje të pashpjegueshme të muskujve, butësi, apo dobësi. Kjo është për shkak se në raste të rralla, problemet e muskujve mund të jenë serioze, duke përfshirë shkatërrimin/ndarjen e muskujve duke rezultuar në dëmtimin e veshkave, dhe shumë rrallë kanë ndodhur vdekjet.

Rreziku i dëmtimit të muskujve është më i madh gjatë dozave më të larta të Vasilipit, posaçërisht tek doza prej 80 mg. Rreziku i shkatërrimit të muskujve është më i madh në pacientë të caktuar. Bisedoni me mjekun tuaj nëse ndonjë nga këto vlen për ju:

- konsumoni sasi të mëdha të alkoolit,
- keni probleme me veshka,
- keni probleme me gjendrën tiroide,
- keni 65 ose më shumë vjet,
- jeni femër,
- keni pasur ndonjëherë probleme me muskuj gjatë trajtimit me barnat për uljen e kolesterolit të quajtur "statina" ose fibrate,
- nëse ju ose anëtar i afërt i familjes ka një çrregullim të trashëguar të muskujve.

Gjithashtu, lajmëroni mjekun tuaj ose farmacistin nëse keni dobësim të muskujve i cili është konstant. Mund të nevojiten teste shtesë për diagnozën dhe trajtimin e kësaj gjendje.

Fëmijët dhe adoleshentët

Siguria dhe efikasiteti i simvastatinës është hulumtuar tek djemtë e moshës prej 10-17 vjet dhe tek vajzat të cilat kanë marrë periudhën e tyre të parë menstruale të paktën një vit më parë (shih seksionin 3: Si e marrim Vasilipin). Vasilipi nuk është hulumtuar tek fëmijët më të vegjël se 10 vjet. Për më shumë informacione, bisedoni me mjekun tuaj.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem informoni mjekun ose farmacistin tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barna që merren pa recetën e mjekut.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme që ti tregoni mjekut tuaj nëse jeni duke marrë ndonjë nga barnat në vijim. Duke marrë Vasilip-in me ndonjë nga këto barna mund të rritet rreziku i problemeve të muskujve (disa nga këto tashmë janë të shënuara në seksionin e mësipërm "Keni kujdes të veçantë me Vasilip"):

- ciklosporin (një bar që përdoret shpesh te pacientët e transplantimit të organeve),
- danazol (një hormon human që përdoret për të trajtimin e endometrioze),
- barnat si itrakonazol, ketokonazol, flukonazol, ose posakonazol (barnat që përdoren për infeksionet fungale),
- fibrate si gemfibrozil dhe bezafibrate (barna për uljen e kolesterolit),
- eritromicin, klaritromicin, telitromicin, ose acid fusidik (barna që përdoren për infeksionet bakteriale),
- frenuesit e HIV proteazës si indinavir, nelfinavir, ritonavir, dhe sakuinavir (barna që përdoren për trajtimin e AIDS),

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

- bar antiviral kundër hepatitit C, siç është boceprevir, telaprevir, elbasvir ose grazoprevir (që përdoret për trajtimin e infeksionit viral të hepatitit C),
- nefazodon (bar për trajtimin e depresionit),
- barnat me përbërës aktiv cobicistat,
- amiodaron (bar që përdoret për rrahje të parregullta të zemrës),
- verapamil, diltiazem ose amlodipin (barna për trajtimin e tensionit të lartë të gjakut, dhimbje gjoksi të shoqëruar me sëmundje të zemrës, ose gjendja të tjera të zemrës),
- lomitapid (përdoret për trajtimin e gjendjes serioze dhe të rrallë të kolesterolit gjenetik),
- kolkicina (bar që përdoret për të trajtuar gihtin),
- nëse nevojitet të merrni acid fusidinik oral për trajtimin e infeksionit bakterial, duhet përkohësisht ta ndërpreni përdorimin e këtij bari. Mjeku juaj do të ju tregojë kur është e sigurtë që përsëri të merrni Vasilip. Aplikimi i Vasilip me acidin fusidinik rrallë mund të sjellë deri tek dobësimi i muskujve, ndjeshmëria ose dhimbja (rabdomioliza). Shihni informacionet shtesë në lidhje me rabdomiolizën në seksionin 4.
- ticagrelor (bar për antiagregacion)

Ju lutemi tregoni mjekut apo farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit ndonjë bar tjetër, duke përfshirë edhe ato të marra pa recetë, si dhe barnat e sipër përmendura. Në veçanti, tregoni mjekut tuaj nëse jeni duke marrë ndonjë nga këto:

- barnat për të parandaluar mpiksjen e gjakut, të tilla si varfarina, fenprokumon, ose acenokumarol (antikoagulantët),
- fenofibrate (një tjetër bar për uljen e kolesterolit),
- niacin (një tjetër bar për uljen e kolesterolit),
- rifamapicin (një bar përdoret për trajtimin e tuberkulozit).

Gjithashtu, tregoni mjekut tuaj nëse merrni niacinë (acid nikotinik) ose produkt i cili përmban niacinë ose jeni me prejadhje Kineze.

Duhet ti tregoni mjekut i cili e përshkruan barin e ri, që jeni duke marrë Vasilip.

Marrja e Vasilip me ushqim dhe pije

Lëngu i grejpfrutit përmban një ose më shumë komponentë që ndryshojnë se si organizmi i përdor disa produkteve medicinale, duke përfshirë Vasilip. Konsumimi i lëngut të grejpfrutit duhet të shmanget.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkoni këshillë nga mjeku ose farmacisti para përdorimit të barit.

Mos e merrni Vasilip nëse jeni shtatzënë, nëse jeni duke planifikuar shtatzëninë apo mendoni se mund të jeni shtatzënë. Nëse ju mbeten shtatzënë, deri sa jeni duke marrë Vasilip, ndërpreni menjëherë dhe kontaktoni me mjekun tuaj. Mos merrni Vasilip nëse jeni duke ushqyer fëmijun me gji, sepse nuk është e njohur nëse bari kalon në qumështin e nënës.

Ngasja e automjeteve dhe përdorimi i makinerive

Vasilip nuk pritet të ndërhyjë në aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin apo për të përdorur makineri. Megjithatë, duhet të merret parasysh se disa njerëz kanë marramendje pas marrjes së Vasilip-it.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Vasilip

Vasilip përmban laktozë. Nëse mjeku ju ka thënë se jeni jotolerantë ndaj ndonjë sheqeri, drejtohuni te mjeku para se ta aplikoni këtë bar.

3. SI TA MERRNI VASILIP

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Gjithmonë merrni Vasilip saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt.

Ju duhet të qëndroni në një dietë për uljen e kolesterolit gjatë marrjes së Vasilip-it.

Dozimi:

Doza e rekomanduar Vasilip 10 mg, 20 mg, 40 mg ose 80 mg është një tabletë një herë në ditë në gojë.

Të rriturit:

Doza e zakonshme fillestare është 10, 20 ose, në disa raste, 40 mg në ditë. Mjeku juaj mund ta përshtatë dozën tuaj më së paku pas 4 javëve deri në dozën maksimale prej 80 mg në ditë. Mos merrni më shumë se 80 mg në ditë.

Mjeku juaj mund të përshkruajë doza më të vogla, posaçërisht nëse merrni bar të caktuar të lartëpërmendur ose keni ndonjë gjendje të caktuar të veshkëve.

Doza 80 mg është e rekomanduar vetëm për pacientët e rritur me nivelet të larta të kolesterolit dhe në rrezik të lartë të problemeve të sëmundjeve të zemrës të cilët nuk kanë arritur qëllimin e tyre të kolesterolit në doza më të ulëta.

Përdorimi tek fëmijët dhe adoleshentët:

Për fëmijët (10-17 vjet), doza fillestare e zakonshme e preferuar është 10 mg në ditë, e marrë në mbrëmje. Doza maksimale e preferuar është 40 mg në ditë.

Mënyra e përdorimit:

Merrni Vasilip në mbrëmje. Mund t'a merrni me ose pa ushqim. Vazhdoni të merrni Vasilip derisa mjeku nuk ju thotë ta ndërpreni.

Nëse mjeku juaj ju ka përshkruar Vasilip së bashku me barna për zvogëlimin e kolesterolit i cili lidhë acidet biliare, merrni Vasilip së paku 2 orë para ose 4 orë pas marrjes së sekuestruesit që lidhë acidet biliare.

Nëse merrni Vasilip më shumë se që duhet

Nëse merrni Vasilip më shumë se që duhet, kontaktoni me mjekun tuaj ose farmacistin menjëherë.

Nëse harroni të merrni Vasilip

Mos e dyfishoni dozën për ta kompenzuar dozën e humbur.

Merrni dozën e radhës në kohën e zakonshme, të nesërmen.

Nëse e ndërprisni marrjen e Vasilip

Niveli i kolesterolit mund të rritet përsëri.

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtoheni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Vasilip mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse ato nuk paraqiten te të gjithë.

Termet vijuese janë përdorur për të përshkruar se sa shpesh efektet anësore janë raportuar:

- Rrallë (mund të ndikojë te 1 në 1.000 njerëz)
- Shumë rrallë (mund të ndikojë te 1 në 10.000 njerëz)
- Nuk dihet (frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave në dispozicion)

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Në vijim efektet e rënda anësore të rralla janë raportuar.

Nëse ndonjë nga këto efekte anësore serioze ndodhë, ndërpreni marrjen e barit dhe tregoni menjëherë mjekut tuaj ose të shkoni në dhomën e urgjencës në spitalin më të afërt.

- Dhimbje të muskujve, butësi, dobësi, ruptura e muskujve apo dhimbje barku. Në raste të rralla, këto probleme me muskuj mund të jenë serioze, duke përfshirë shkatërrimin/ndarjen e muskujve duke rezultuar në dëmtimin e veshkave, dhe shumë rrallë vdekjet kanë ndodhur.
- Reaksione të mbindjeshmërisë (alergjik), duke përfshirë:
 - ënjtje të fytyrës, gjuhës dhe fytyrës të cilat mund të shkaktojnë vështirësi në frymëmarrje, (angioedema),
 - dhimbje të forta të muskujve zakonisht në supe dhe kuka,
 - skuqe me dobësi të gjymtyrëve dhe muskujvë të qafës,
 - puçrra që mund të paraqiten në lëkurë ose ulçera në gojë (erupsione lihenoidale të barnave)
 - dhimbje ose inflamacion i nyjave,
 - pezmatimi i enëve të gjakut,
 - mavijosje jo e zakonshme, erupsione lëkure dhe ënjtje, urtikarie, ndjeshmëri e lëkurës ndaj diellit, ethe, nxehtësi/skuqe,
 - frymëmarrje e shkurtuar dhe nuk ndjeheni mirë,
 - lupus (duke përfshirë edhe skuqe, çrregullime të nyjeve, dhe efektet në qelizat e gjakut).
- Inflamacioni i mëlçisë me këto simptoma: ngjyra e verdhë e syve dhe lëkurës, kruajtje, urina e errët ose jashtëqitja me ngjyrë të zbehtë, lodhja dhe dobësia, humbja e apetitit; insuficienca e mëlçisë (shumë rrallë).
- Inflamacion i pankreasit shpesh me dhimbje të forta të barkut.

Janë paraqitur këto reagime serioze shumë të rralla:

- reagim alergjik serioz që shkakton vështirësi në frymëmarrje ose marramendje (anafilaksa)
- ginekomastia (rritja e gjinjve të meshkujt)

Efektet anësore të mëposhtme gjithashtu janë raportuar rrallë:

- ulje e numrit të qelizave të kuqe të gjakut (anemi),
- mpirje ose dobësi të duarëve dhe këmbëve,
- dhimbje koke, ndjesi shpimi gjilpërash, marramendje,
- shikim i turbullt, dëmtim i shikimit
- çrregullimet e tretjes (dhimbje barku, kapsllëk, fryrje, mostretje, diarje (barkqitje), mundim, vjellje),
- skuqe, kruajtje, humbje e flokëve,
- dobësi,
- problemet me gjumë (shumë rrallë),
- kujtesa e dobët (shumë rrallë), humbja e kujtesës, konfuzioni.

Këto efekte të padëshiruara gjithashtu janë publikuar, por frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave në dispozicion (frekuenca nuk dihet):

- disfunksioni erektil,
- depresioni,
- ndezja e mushkërive që paraqet problem me frymëmarrjen, përfshirë kollitjen e vazhdueshme dhe /ose vështirësi në frymëmarrje ose ethe,
- problem me tetivën, ndonjëherë këputja e tetivës.

Efektet e mundshme të padëshiruara shtesë janë regjistruar me disa statine:

- pagjumësia, përfshirë edhe ankthin,
- problemet seksuale,

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

- diabeti. Kjo është edhe më e mundshme nëse keni nivel të lartë të sheqerit dhe yndyrësve në gjak, mbipeshë dhe presion të lartë të gjakut. Mjeku juaj do të ju monitorojë derisa jeni duke marrë këtë bar.
- dhimbje në muskuj, ndjeshmëri dhe dobësi e cila është konstante dhe e cila nuk mund të humbë pas ndërprerjes Vasilipit (frekuenca nuk dihet).

Vlerat laboratorike

Janë vërejtur rritje të vlerave të funksionit të mëlçisë dhe enzimeve të muskujve (kreatinë kinaza) në disa hulumtime laboratorike në gjak.

Paraqitja e efekteve anësore

Nëse ju paraqitet çfarëdo efekti anësor, njoftoni mjekun tuaj ose farmacistin. Kjo përfshin çfarëdo efekte anësore që nuk janë shënuar në këtë udhëzim. Efektet anësore mund ti paraqitni drejtpërdrejtë nëpërmjet sistemit nacional për raportim.

Me paraqitjen e efekteve anësore mund të ndihmoni në ofrimin e më shumë informacioneve rreth sigurisë së këtij medikamenti.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk përfshihet në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET VASILIP

Fëmijët të mos kenë qasje në këtë bar.

Mos e përdorni Vasilip pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Të ruhet temperaturë deri në 30°C.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave shtëpiake. Pyeteni farmacistin se si t'i largoni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta ruajtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Vasilip

Substanca aktive është simvastatin.

1 film tabletë e mbështjellur përmban 10 mg, 20 mg, 40 mg simvastatin.

Përbërësit e tjerë janë: monohidrat laktoze, amidon i paraxhelatinizuar, butilhidroksianizor (E320), acid citrik (E330), acid askorbik (E300), amidon, celulozë mikrokristaline (E460) dhe stearat magnezi (E470b) në bërthamën e tabletës, dhe hipromelozë (E464), talk (E553b), propilen glikol (E1520), dhe dioksid titani (E171) në mbështjellësin e tabletës.

Shihni seksionin 2 “Vasilip përmban laktozë”.

Si duket bari Vasilip dhe përbërja e paketimit

Film tabletat të mbështjellura 10 mg, 20 mg janë të rrumbullakëta, pak bikonvekse, me ngjyrë të bardhë.

Film tabletat e mbështjellura prej 40 mg janë të rrumbullakëta, pak bikonvekse, të bardha, të shtypura në njërin anë. Tableta mund të ndahet më dy doza të barabarta.

Vasilip është në dispozicion në kuti prej 28 film tabletave të mbështjellura në 4 blistera me nga 7 tableta.

1.3.1	Simvastatin
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO

Bartësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax:+386 7 332 27 42

www.krka.si

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet me recetë të mjekut.

Data e fundit e miratimit të fletudhëzimit

Qershor 2020